



PEMA

Project EMilia-Romagna for Albania

BIODIVERSITETI NË SHQIPËRI MUNDËSI ZHVILLIMI

Përgatitur nga:

Prof. As. Dr. Zef GJETA

02 Nëntor 2022, UBT Kamëz

HYRJE

Shqipëria karakterizohet nga një pasuri e konsiderueshme e ekosistemeve dhe habitateve tokësore dhe detare me lloje të ndryshme flore dhe faune, pjesa më e madhe e vendit është kryesisht me karakter mesdhetar.

Përveç diversitetit të topografisë dhe klimës, afërsia e drejtpërdrejtë e Shqipërisë me detin Mesdhe dhe vendndodhja e rëndësishme brenda kontinentit, kanë krijuar kushte të favorshme për shfaqjen e një game të gjerë flore dhe faune me një cilësi të jashtëzakonshme, e cila, megjithatë, ka udhëhequr vend të njihet si një pikë e rëndësishme e biodiversitetit në kontinent.

Numri i specieve faunale të kërcënuara globalisht në Shqipëri është shumë i lartë, e jo mirë për BioDiversitetin e një shteti, me një pjesë integrale prej më shumë se 181 speciesh, numër ky i konsidertueshëm.

TË DHËNA TË PËRGGJITHËSHME

Kushtet klimaterike, tokësore si dhe relievi i Shqipërisë përbejnë tabanin për një zhvillim të diversitetit si përsa i takon florës ashtu edhe faunës, gjë që pasqyrohet në një numër të konsiderueshëm të bimëve dhe të kafshëve të njohura me origjinë të ndryshme, por edhe i bimëve dhe kafshëve endemike.

Rrjeti hidrografik i Shqipërisë përbëhet nga liqene, lumenj, ligatina, dete dhe ujëra nëntokësor, ku janë rreth 250 liqene me origjinë të ndryshme, duke përfshirë liqene tektonike, akullnajore dhe lunore. Ndërkohë që në Shqipëri janë 152 lumenj më gjatësi të ndryshme.

Në Shqipëri janë përcaktuar 799 lloje zonash të mbrojtura, me një sipërfaqe prej 5216,96 kilometra katrorë. Midis tyre janë 14 parqe kombëtare, 1 park detar, 4 zona Ramsar, 3 vende të trashëgimisë botërore, 45 zona të rëndësishme bimore, 16 zona të rëndësishme të shpendëve dhe 786 zona të mbrojtura të kategorive të ndryshme.

TË DHËNA TË PËRGGJITHËSHME

Institucionet në vend, nuk arrijnë të raportojnë me saktësi mbi llojet, ndërsa numri shkon në rreth 55 mijë, kjo për shkak se mungon një regjistër i mirëfilltë i florës në vend. Flora e Shqipërisë është paraqitur nga 165 familje me 910 gjini.

Ndërkohë që flora e Shqipërisë përbëhet nga më shumë se 3200 bimë vaskulare dhe 2350 bimë jo vaskulare dhe një numër më pak i njohur kërpudhash. Elementet kryesore të florës së vendit janë 24% mesdhetare, 22% ballkanike, 18% europiane dhe 14% euroaziatike.

Mbi 353 lloje shpendësh janë regjistruar në Shqipëri dhe rreth 58 lloje gjitarësh janë regjistruar në vend. Shqipëria ka rreth 249 lloje peshqish në ujërat e saj bregdetare dhe 64 lloje të ujërave të ëmbla në lumenjtë dhe liqenete e saj. Shqipëria ka jo me pak se 14 lloje lakuriqe nate.

NJË KLASIFIKIM I THJESHTË

Më konkretisht kemi mundësi që të bëjmë një diferencim të thjeshtë të diversitetit natyror në vend në lidhje me faunën dhe florën:

- Bimë dhe kafshë të kultivuara (me origjinë të përzier/vendase të huaj);
- Bimë dhe kafshë të egra (kryesist vendase, me zhvillim spontan);
- Bimë dhe kafshë autoktone/endemike;
- Bimë dhe kafshë të reja (që njohen edhe si ekzotike)

KAFSHË SHQIPTARE



BIMË SHQIPTARE



AVANTAZHET E BIODIVERSITETIT

Biodiversiteti është i rëndësishëm për disa arsye:

- * 80% e furnizimit me ushqime vjen nga 20 varietete bimësh dhe 40,000 specie;
- * Përveç ushqimit siguron materiale dhe ndikon në ekonomi;
- * Studimi i biologjisë dhe gjenetikës së bimëve dhe kafshëve ndihmon fushën e mjekësisë për kurimin e sëmundjeve;
- * Biodiversiteti mundëson shërbimet ekologjike nga pastrimi i ujit deri te sigurimi i oksigjenit;
- * Biodiversiteti lejon përshtatjen e ekosistemeve;
- * Biodiversiteti parandalon sëmundjet dhe ndihmon speciet të përshtaten me ndryshimet në mjedisin e tyre;
- * Mund të shfrytëzohet “niche” market;
- * Krijon mundësi të shtimit të turizmit elirat dhe atij ekstravagant.

KU JEMI AKTUALISHT?!

Aktualisht, vendi ynë është në një stad shumë fillestar në lidhje me biodiversitetin, dhe disa nga treguesit janë:

* Në Shqipëri ka studime në lidhje me njohje e llojeve të bimëve e të kafshëve të radha apo endemike si dhe zonat e shpërndarjes ;

(Këto studime janë relativisht të pa përditësuara, kryesisht në lidhje me shtrirjen e tyre reale dhe numrin apo sipërfaqen që mbulojnë)

* Disa bimë dhe kafshë të radha dhe/ose endemike janë studiuar deri në imtësi, por jo të gjitha;

(këto studime kanë mbetur në letër dhe nuk kanë gjetur mundësinë të shtrihen në përdorimin real në dobi të ruajtjes dhe zhvillimit të tyre, por edhe të zhvillimit të vendit)

* është një numër i kufizuar i njerëzve që kanë njohuri të shkallëve të ndryshme, në lidhje me biodiversitetin në vend;

(studimet janë të kufizuara në kopje dhe shpesh shumë teorike, pa dhënë sugjerime për ruajtje dhe zhvillim)

ÇFARË DUHET TË BËJMË?!

Shumë prej ekonomistëve apo njerëzve kyç për zhvillimin shtrojnë pyetjen:

KUSH ËSHTË KIVI PËR ZHVILLIMIN E VENDIT?!

Kjo “përkthehet” në pyetjen: Cila është bima që do të përcaktojë zhvillimin e vendit , në mënyrë të qëndrueshme dhe me efekte shumë të qënësishme?

Dhe për mendimin tim, kësaj pyetje nuk i është dhënë përgjigje deri më tani.

A KA NJË PËRGJIGJE PËR KËTË?!

KU JEMI AKTUALISHT?!

Megjithëse prej më shumë se 10 vitesh po këmbëngul në përgjigjen time, akoma nuk kam gjetur mbështetje.

Megjithatë mendoj se përgjigja është:

BIMËT MANORE (TË NJOHURA SI BERRY)....

MANAFERRAT

MJEDRRRAT

LULUSHTRYDHET

BORONICA, por edhe...

RRUSHI I ARIUT

KULUMBRIA

VOESA, ETJ



JU FALEMINDERIT!